



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 500/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Rafet Haxhaj kryesues, Vllastimir Dimic dhe Ferid Osmani, anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 14.12.2010, mori këtë:

VENDIM

REFUZOHEN si të pabazuara ankesat me nr. A-500, A-501, A-502 dhe A-503, të datës 13.12.2010, të subjektit politik Partia Demokratike Kosovës (PDK) kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

Arsyetim

Më 13 dhjetor 2010, PZAP-i ka pranuar 4 (katër) ankesa, me numër A500, A501, A502 dhe A503 paraqitur nga PDK kundër subjektit politik LDK në të cilat pretendohet se :

Me date 12.12.2010 ne shkollën “Ismail Qemali” ne Prishtine rreth orës 13:30 dy te persona dyshimte (simpatizantë te LDK-se) të cilët nuk ishin te angazhuar ne procesin e votimit, kishin pamje te shqetësuese;

Gjate dites se zgjedhjeve ne shkollat Meto Bajraktari, Emin Duraku, Asim Vokshi, Zenel Hajdini dhe Nazim Gafuri ne Prishtine, zyrtare te komunës se Prishtinës me automjete zyrtare kane bere shkelje te shumta, duke kontrolluar shkollat dhe votuar disa here;

Ne 12.12.2010 ne shkollen fillore Emin Duraku ne Prishtine diku rreth ores 11:20 kryetari i deges se PDK-se per Prishtine Ramadan Avdiu, pasi votoj ne kete QV ne korridor te shkollës eshte provokuar nga militantet e LDK-se, per kete rast jane informuar edhe organet policore;

Ne shkollen fillore Meto Bajraktari Prishtine sipas vëzhguesve dhe komisionereve te PDK-se ka pasur parregullsi te shumta nga ana elektoratit, komisionarëve dhe vëzhguesve te LDK-se. Sipas parashtruesit te ankesës, parregullsitë kishin te bënin me votim te dyfishte, votim për persona te tjerë.

Ne mbështetje te pretendimeve, parashtruesi i ankesave nuk ka bashkangjitur asnjë prove.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) dhe neni 6.3 parashohin si vijon:

3.6 (c) hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.

6.3. Me qëllim të lehtësimit të shyrimit të ankesave, kryesuesi i panelit mund të vendose ta bej bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, paneli vendimmarrës i trajton ato si kur të ishin një ankese.

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoj të gjitha shkresat e lendes gjeti se:

- ankesat janë të pabazuara

Nga shkresat e lendes PZAP vlerëson se ankesat e subjektit politik PDK, ka mungesë të provave për t'u bindur se ka pasur parregullsi gjatë votimit si dhe nuk është ofruar asnjë provë si dëshmi bindëse për parregullsinë e pretenduar. Për këto arsye, dhe duke u bazuar në dispozitat e lartpërmendura si dhe në kuptimin e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

A nr. 500/2010 më datën 14.12.2010.



**Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj**